# Protokoll

I mbajtur sot me datë 28.10.2024, më orën 12:00 në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak me këtë rend dite:

1. Miratimi i P. Vendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës ekonomike 6% për muajin Shtator 2024.

2. Njohja mbi planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

3. Paraqitja për njohje mbi ndryshimet në VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".

4. Miratimi i kërkesës për marrje në përdorim të fondit pyjor/kullosor të Bashkisë Fushë-Arrëz për "Kanalin e linjës së ujit në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz".

5. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura e Qarkut.

6. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

7. Të ndryshme.

Në këtë mbledhje morën pjesë: kryetari i Këshillit Z. Nikolin Bardhoku, kryetari i Bashkisë Z. Hil Curri, Specialistja e Këshillit Zj. Valbona Milla, Drejtori i Pyjeve dhe Kullotave Z. Ardmin Doda, Përgjegjëse për çështjet sociale Zj. Fitnete Arifaj, Përgjegjësja e sektorit juridik Zjsh. Redona Hasani, Përgjegjësi i sektorit të Urbanistikës Z. Jonin Prenga.

Gjithashtu morën pjesë edhe këshilltarët:

1. Nikolin Bardhoku
2. Bardhok Qafa
3. Nikolin Sadiku
4. Valentina Lleshaj
5. Franc Doda
6. Pavlin Qafa
7. Besjana Marku
8. Tereze Dema
9. Zef Cara.
10. Vjollca Tabakaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
86

Mbledhjen e hapi kryetari i këshillit i cili mbajti një fjalim sensibilizues për muajin Teto[...] i cili quhet muaji Rozë, për kancerin e gjirit.

Lexon rendin e ditës dhe hidhet në votim.

10 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.

Miratohet rendi i ditës.

Pika 1.

F. Doda -> Kemi marrë vendim në mbledhje[...] e komisionit. Kemi vetëm familjen e Z. Prend Las[...] që është familje e varfër, ku kryefamiljari është i sëmurë dhe nuk punon dot. Nuk kemi propoz[...] të bëhet asnjë ndryshim, prandaj ju ftoj ta votojmë[...]

Hidhet në votim.: 10 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.

N. Bardhoku: 6% u votua me 10 vota pro.

Miratohet pika 1 e rendit të ditës.

......,........,

Pika 2.

R. Hasani → Janë të përmbledhura në tabelë, është njohëse, jo për vendimmarrje. Këto detyra do të realizohen pothuajse 100%. Janë detyra të lëna nga KLSH.

M. Aga → Kemi detyrim të marrim më shumë se dy punonjës të kadastrës, pasi kemi vetëm njëdhe ka ngarkesë të madhe. Të paktën 2 duhen.

N. Bardhoku → Janë standarte ligjore që duhet të zbatohen, ne do të kërkojmë nga zyrat informacion për çdo zyre që ~~të~~ na sjellin për punët vjetore. Përshkrimi i punës të jetë për çdo të punësuar, si në njësitë ashtu edhe për Bashki

Pika 3.

N. Selimaj → Është informacion për njohje, jo për vendimmarrje. Aplikimi për objektet Tip bëhet në e-Albania, të plotësohet formulari, dokumentet që vërtetojnë të drejtën e pronësisë, leje ndërtimi. Autoriteti vendor përgatit disa dokumenta, planvendosje, projektin dhe grafikut. Ka afat 30 ditë nga data e aplikimit. Afati i miratimit është data 12.12.2024

N. Bardhoku → Të shpërndahet dhe të informohen qytetarët, pasi është ndryshim 100%. Ky ligj është që në vitin 1994 por që është ndryshuar dhe ky ndryshim është shumë ndihmues për qytetarin. Të publikohet ky ndryshim.

Pika 4.

A. Doda → Bën prezantimin e projektit. për d

toke me përdorim. Në bashkinë tonë kalon vetëm tubi, burimi është në territorin e Pukës. Është bërë dëgjesa publike dhe është ligjore çdo gjë. Jemi me kërkesë, P.V, relacion Harta topografike, Raporti tekniko-ekonomik, Këshilli as pyjorja nuk vendosin për tokat bujqësore dhe troje. Japim prona me VKM të caktuar. Afati kohor për kanalin është 1 vit.
N. Bardhi: Synimi është të rriten financat e Bashkisë. Në bazë të dëgjesës ne kemi kuptuar se nuk ka probleme me banorët dhe as me pronat bujqësore. Nuk kalohet në tokën e askujt. Ne votojmë procedurën. Dokumentacioni është i plotësuar dhe hidhet në votim.

Votohet me: 10 vota pro
0 vota kundër
0 vota abstenim.

Miratohet pika 4 e rendit të ditës.

Mbledhja mbyllet!

Pavlin Qafa
Franc Doda
Bardhok Qafa
Nikolin Bardhoku
Besjana Marku
Valentina Lleshaj
Tereze Dema
Zef Cara
Kolica Tabakaj

Sekretare
Naze Sebmaj

Mbajti Protokollin
Valbona Milla